

Lutja, thelbi i adhurimit dhe i shpresës së besimtarit

Nga hoxhë Sokol Kondakçi

Cdo njeri në jetën e tij luhet mes gëzimit dhe hidhërimit, mes mirësive dhe ligësive, mes vështirësisë dhe lumturisë dhe vitet shpejtojnë me ta në jetën e tyre duke kaluar disa vite të begata e disa të tjerë të vështira dhe kjo është natyra e jetës në këtë botë. Sido që të jetë në të dyja rastet njeriu është në gjendje të mirë, nëse gjatë kësaj jete zemrën e tij e ka pasur të lidhur me Zotin e tij nëpërmjet ibadetit, i cili është ushqimi i shpirtit dhe më i miri mik shoqëruar në këtë jetë.

Në ditët e sotme të modernitetit ndodh të dëgjojmë shpesh herë për zbulime të reja shkencore, të cilat kanë të bëjnë me hapësirat oqeanike dhe ato kozmike. Dëgjojmë për prohimin e armëve të reja dhe moderne, të cilat janë bërë pjesë përbërëse kryesore në përcaktimin e forcës apo të dobësisë së një shteti. Padyshim armatimi për një shtet është garanti i mbrojtjes së fitoreve dhe arritjeve të një populli.

Në fakt ekziston një lloj arme, e cila nuk prodhohet, as në fabrikat perëndimore e as në ato lindore dhe është një armë, e cila ka fuqi dhe precizion më të lartë dhe më e çuditshmja është se këtë armë e zotërojnë vetëm një kategori e caktuar njerëzish. Janë besimtarët ata që e zotërojnë këtë armë, atë e kanë zotëruar profetët dhe besimtarët që kanë besuar në një Zot për gjatë gjithë historisë njerëzore.

Me këtë armë Allahu i Madhëruar shpëtoi profetin Nuh alejhi selam, nga përmbytja, shpëtoi Musain alejhi selam nga Tirania e Faraonit, shpëtoi Salihun alejhi selam dhe shkatërroi popullin Themud, shpëtoi profetin Hud dhe poshtëroi popullin Ad jobesimtar, të cilët e përgënjeshtroan, triumfoi Muhamedin alejhi selam në shumë



momente të jetës së tij. Me këtë armë Profeti Muhamed u përball me dy fuqitë më të mëdha të kohës dhe doli fitimtar dhe bashkë me të triumfuan besimtarët dhe feja Islame.

Kjo armë e fuqishme është lutja. I Dërguari i Allahut Muhamedi alejhi selam në një hadith që transmetohet në përmbledhjen e Tirmidhiut ka thënë: "Lutja është truri i adhurimit" dhe pastaj lexoi ajetin kuranor: "Zoti juaj ka thënë: Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë në nënçmuar në Xhehenem". Duhet ta dimë se lutja është diçka madhështore dhe ajo ka rregullat dhe edukatën e saj.

Së pari: duhet të dimë se cilat janë ditët, javët, muajt dhe momentet më të volitshme për t'u lutur, që lutjet tona të jenë të garantuara. Gjatë vitit është dita e Arafatit, gjatë javës është dita e xhuma, nga muajt është muaji Ramazan, nga momentet, është koha para agimit dhe

koha mes ezanit dhe ikametit etj...

I Dërguari i Allahut ka thënë në një hadith: "Lutja që bëhet mes Ezanit dhe ikametit nuk kthehet mbrapsht." (Ahmedi). I Dërguari i Allahut Muhamedi alejhi selam thotë: "Në ditën e xhuma është një moment, që nëse lutjet e besimtarit përkojnë me të Allahu do t'ia plotësojë kërkesën e tij, por ai është moment i shkurtër". (Buhari dhe Muslimi)

Në një thënie tjetër i Dërguari i Allahut thotë: "Në pjesën e fundit të natës Zoti juaj zbret në qiellin e dunjasë dhe thotë: Kush më lutet do t'ia përgjigjem, kush do më kërkojë diçka do t'ia plotësojë kërkesën, kush do më kërkojë falje do ta fal". (Buhari, Muslimi)

Së dyti: Kohët e pëlqyera për t'u lutur janë: Momente vështirësie kur njeriu ndihet ngushtë dhe ka nevojë për ndihmë, kur bie shi, në namaz kur jemi në sexhde, në momentin e çeljes së iftarit kur jemi agjërues, dhe kur jemi në udhëtim.

Në lidhje me sexhden i Dërguari i

Allahut thotë: "Besimtari është më pranë Zotit kur ai bën sexhde, ndaj i shtoni lutjet në sexhde." (Muslimi)

I Dërguari i Allahut thotë: "Tre Lutje janë të pranueshme pa asnjë lloj dyshimi në to: Lutja e prindit për fëmijën, lutja e udhëtarit dhe lutja e atij që i është bërë padrejtësi". (Ebu Daudi) Në një hadith tjetër profeti Muhamed alejhi selam thotë: "Tre vetëve nuk iu refuzohet atyre lutja: Agjëruesit deri sa ta çele iftarin, imami i drejtë dhe lutja e atij që i është bërë padrejtësi, lutjen e tij Zoti e ngren lart reve dhe i thotë: Pasha Krenarinë time do të ndihmoj ty qoftë edhe pas një kohe." (Tirmidhiu)

Së treti: Nga edukata e lutjes është drejtimi nga Kibla, ngritja e duarve nga qielli dhe lutja me zë të ulët duke mos u munduar që lutja të jetë me rimë. Kjo sepse gjendja e lutësit duhet të jetë gjendje devocioni dhe frikë-shprese dhe përlulshmërie, gjë e cila nuk i jep mundësinë e thurjes së vargjeve me rimë dhe kjo për të qenë sa më i thjeshtë dhe më i drejtpërdrejtë me Krijuesin e tij. Allahu i Madhëruar thotë: "E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen Mua dhe le të më besojnë Mua." (Bekare 186) Në suren Isra Allahu i Madhëruar thotë: "E ti mos e ngre zërin (duke lexuar) në Lutjen tënde, po as mos e ul tepër në të, e mes kësaj kërkoje një rrugë mesatare". (Isra 110)

Dijetari i njohur islam Ibn Haxheri thotë në lidhje me këtë verset uranor, se kur dikush i lutet Zotit për falje mëkatesh, nuk duhet ta ngrejë zërin e tij me qëllim që të mos përhapë pa dashje gjynahet e tij duke e ngritur zërin. E lusim Allahu Fuqplotë të na bëjë prej robërve të Tij adhurues ndaj tij dhe lutës të Tij në çdo kohë.

Fq 4 / Aborti problem social dhe mëkat hyjnor

Nga hoxhë Ervin Qylafku

Fq 4 / Cikli i haditheve të dobëta dhe të trilluara

Nga hoxhë Mustafa Tërniqi

Fq 5 / Hamami dhe kultura e të larit në botën muslimane

Nga Roald A. HYSA

Fq 6 / Rregullat themelore të Ekonomisë Islame mbi pronën

Nga P.P. Abdul-Rrezaku

الجماعة رحمة والفرقة عذاب
LHSH

ADMINISTRON ZEKATIN TUAJ

Për zekatin në lekë:
IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB
Llogaria në lekë:
IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA
Llogaria në Euro:
IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO
Llogaria në Dollarë:
IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
Tel: 0672304520 /0672538334/048320160
BKT Banka Kombëtare Tregtare
Nr. i llogarisë : 52416329

Fetva / Akademia e Fikhut Islam me qendër në Mekë

Përdorimi i ilaçeve që përmbajnë alkool dhe drogë

Së pari: Nuk lejohet përdorimi i drejtpërdrejtë i pijeve dehëse, si bar kurues. Argument për këtë është thënia e të Dërguarit të Allahut (alejhi salatu ue selam): "Allahu nuk e ka vendosur shërimin tuaj në gjërat që ua ka ndaluar." (Trasmeton Buhariu) Gjithashtu i Dërguari i Allahut (alejhi salatu ue selam) ka thënë: "Allahu e ka zbritur sëmundjen dhe për çdo sëmundje ka një kurë, prandaj mjekohuni dhe mos u mjekoni me haram." (Ebu Daudi, Ibn Es-Suni dhe Ebu Nuejmi). Kur Profeti u pyet nga Tarik bin Suvejdi për kurën në e cila përzihet me pije alkoolikeai u përgjigj: "Ajo nuk është shërim, por është sëmundje." (Ibn Maxheh, Ebu Nuejmi)

Së dyti: Lejohet përdorimi i ilaçeve që kanë në përbërjen e tyre alkool në përqindje të konsumueshme (që nuk japin efekt dehës), kur kjo është edomosdoshmenë prodhimin e kurave të ndryshme dhe në rastet kur nuk ka asnjë alternativë tjetër, por me kusht që ato të rekomandohen nga një mjek i besueshëm dhe i drejtë. Gjithashtu lejohet përdorimi i alkoolit si dezinfektant i jashtëm për plagët, si lëng eliminues për mikrobet dhe në kremrat për përdorim të jashtëm.

Së treti: Akademia e Fikhut Islam u sugjeron të gjitha kompanive të prodhimit farmaceutik në botën islame, si dhe importuesit e këtyre medikamenteve, që të japin maksimumin e mundshëm për të mos përdorur alkoolin dhe për të krijuar alternativa të tjera në vend të tij.

Së katërti: Akademia e Fikhut Islam iu sugjeron gjithashtu edhe mjekëve, që të distancohen nga rekomandimi i medikamenteve që përmbajnë alkool, me sa të kenë mundësi.

<http://www.themwl.org/Fatwa/default.aspx?dë1&cidë150&lëAR&cidë12>

ADN dhe fushat e përfitimit prej saj

Së pari: Lejohet të bazohesh në testin e ADN-së në hetimet penale, si një element ndihmës, që provon një krim, i cili nuk bën pjesë në radhën e ndëshkimeve të përcaktuara në tekste të sheriatit (hudud) dhe as në një dënim kapital, duke u nisur nga argumenti që thotë: "Shmangini ndëshkimet e rënda, vërtetimi i të cilave është i dyshimtë". Nëpërmjet kësaj metode mund të realizohet drejtësia dhe siguria shoqërore dhe ajo mund të bëhet shkas, që kriminelin të marrë ndëshkimin e merituar dhe të lirohet i akuzuari nga akuzat. Kjo në vetvete përbën një nga synimet thelbësore të legjislacionit islam.

Së dyti: Përdorimi i ADN-së në vërtetimin e prejardhjes familjare duhet të realizohet me kujdes të plotë, dhe në fshehtësi totale. Ndaj dhe për këtë arsye tekste të legjislacionit islam (që provojnë prejardhjen) kanë përparësi ndaj rezultateve të ADN-së.

Së treti: Nuk lejohet fetarisht të bazohesh tek testi i ADN-së për të mohuar përkatësinë prindërore të dikujt dhe po ashtu nuk i jepet testit të ADN-së përparësi, në rastet e divorcit me mallkim (kur bashkëshortët në rast dyshimi për thyerjen e kurorës mallkojnë njëri-tjetrin, nëse nuk thonë të vërtetën).

Së katërti: Nuk lejohet përdorimi i ADN-së për të vërtetuar përkatësinë prindërore, që njihet dhe pranohet fetarisht. Në të tilla rastet duhet që autoritetet përkatëse ta ndalojnë këtë gjë dhe të japin dënime të ashpra, sepse kjo cenon nderin e njerëzve dhe vë në diskutim prejardhjen e tyre.

Së pesti: mund të bazohemi tek testi i ADN-së për të vërtetuar prejardhjen në këto raste:

a- Në rastet e konfliktit për prejardhjen e një njeriu që nuk i dihet prejardhja. Këtu përfshihen të gjitha llojet e konflikteve që kanë përmendur dijetarët, qoftë në rastet e konfliktit për një njeri me prejardhje të panjohur, për shkak të mungesës së provave apo kur ato janë të barabarta, apo edhe për shkak të një kontakti seksual nga një martesë e dyshimtë etj.

b- Rastet e dyshimit për foshnjat nëpër spitale, qendrat e kujdesit për fëmijët etj., si dhe po kështu për rastet e dyshimit për fëmijët e lindur me anë të metodës së fekondimit In Vitro.

c- Rastet e humbjes së fëmijëve apo të përzjerjes së tyre për shkak aksidenteve, të fatkeqësive natyrore apo luftërave, për shkak të vështirësisë së identifikimit të familjarëve të tyre, apo për shkak të ekzistencës së kufomave, që nuk ka qenë e mundur identifikimi i tyre, ose me synimin për t'u siguruar për identitetin e robërve të luftës dhe njerëzve të humbur.

d- Nuk lejohet shitja e gjenit njerëzor për një gjini, shtet apo individ, për çfarëdo lloj arsye qoftë, ashtu siç dhe nuk lejohet falja e tij për ndonjë institucion i çdo lloji qoftë, për shkak të pasojave dhe dëmeve të mëdha që sjell kjo praktikë.

e- Akademia sugjeron sa vijon:

1- Shteti duhet të ndalojë çdo kontroll të iniciuar individual të ADN-së, përveç kur kjo bëhet me kërkesën e gjykatës dhe realizohet në laboratorët e organeve përkatëse. Të ndalohet sektori privat, që ka si synim fitimin, që të realizojë këtë test, për shkak se kjo krijon rreziqe të mëdha.

2- Krijimi i një komisioni të veçantë për ADN-në në çdo shtet, në të cilin të marrin pjesë specialistë ligjorë, mjekë dhe zyrtarë, që kanë për detyrë kontrollin e ADN-së dhe zyrtarizimin e rezultateve të saj.

3- Vendosja e një mekanizmi strikt, për të ndaluar mashtrimin dhe vjedhjen, ndotjen dhe çdo përpjekje njerëzore, që synon të fusë hundët në laboratorët e ADN-së. E gjitha kjo që rezultatet të përkojnë me realitetin, të përmbushin konfirmimin e saktësisë së laboratorëve, numri i gjeneve të përdorura për kontroll të jetë i mjaftueshëm, aq sa për të larguar dyshimet, në bazë të asaj që vendosin specialistët.

<http://www.themwl.org/Fatwa/default.aspx?dë1&cidë151&lëAR&cidë12>

Sëmundjet e trashëguara të gjakut

Lavdia i takon Allahut, paqja dhe bekimet e Tij qofshin për Profetin tonë Muhamed, pas të cilit nuk ka profet tjetër, për familjen dhe shokët e tij.

Asambleja e Akademisë së Fikhut Islam me qendër në Mekë, që zhvillon aktivitetin e tij nën kujdesin e Organizatës së Ligës së Botës Islame, në sesionin e saj të shtatëmbëdhjetë të zhvilluar në Mekën e Nderuar, në periudhën ndërmjet 19-23 Sheval 1428 h. (13-17/12-2003) shqyrtoi temën "Sëmundjet e trashëguara të gjakut" dhe sa legjitime është detyrimi i për të kryer analizat mjekësore për ata që dëshirojnë të martohen. Pas dëgjimit të studimeve të paraqitura dhe diskutimeve nga ana e anëtarëve dhe specialistëve për këtë çështje Asambleja vendosi:

Së pari: Akti i martesës bën pjesë në ato akte ku kriteret dhe pasojat ligjore të saj janë vendosur nga vetë Ligjvënësi i Madhëruar, ndaj hapja e kësaj dëre, duke shtuar diçka mbi ligjin islam, siç është detyrimi për të kryer analizat mjekësore para martesës dhe lidhja e zyrtarizimit të këtij akti martesor me këtë kusht, është një veprim që nuk lejohet.

Së dyti: Akademia këshillon qeveritë dhe institucionet islame, që të ndërgjegjësojnë njerëzit për rëndësinë e kryerjes së kontrolleve mjekësore para martesë, që të nxisin popullatën për ta bërë diçka të tillë, të lehtësojnë procedurat e këtyre kontrolleve, për njerëzit që dëshirojnë t'i kryejnë ato dhe që t'i realizojnë ato në mënyrë të fshehtë, duke mos ia treguar rezultatet e këtyre kontrolleve dikujt tjetër përveç atyre që kanë të bëjnë me to në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Burimi: <http://www.themwl.com/Bodies/Researches/default.aspx?dë1&ridë99&lëAR>

Referencat e studimeve që lidhen me këtë fetva mund t'i shikosh në periodikët e publikuar nga akademia në këtë lidhje:

<http://www.themwl.org/Fatwa/default.aspx?dë1&cidë154&lëAR&cidë12>

Ky punim përfshin:

- Sëmundjet e trashëgueshme; disa të vërteta shkencore rreth sëmundjeve të ndërlikuara dhe kronike.

- Martesa me të afërmit; anët pozitive dhe negative të saj.

Gazeta LIDHJA - e përtrejavshme

Bordi botues:
Justinian Topulli
Genc Plumbi
Mustafa Tërniqi

Redaktor përgjegjës:
Roald A. Hysa

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: Teodor Keko mbi Alfa Bank, Tirane-Shqipëri
lidhjahoxhallareve@yahoo.com

Tel & Fax: +355 (0)48320160

<http://www.lidhjahoxhallareve.com>

Oazi i shpirtit / Pasuria e jetimit dhe shpërdorimi i saj

Ngrënia e pasurisë së jetimit padrejtësisht përbën një nga gjynahet e mëdha. Në tw dy Sahihët përcillet nga Ebu Hurejre r.a., se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Shmanguni nga shtatë gjynahet shkatërruese.” Dikush i tha: “Cilat janë ato, o i Dërguari i Allahut?!” Tha: “T’i bësh shok Allahut, magjia, vrasja e njeriut veçse me drejtësi, ngrënia e kamatës, ngrënia e pasurisë së jetimit, zbrapsja në ditën e betejës, shpifja ndaj grave të pastra dhe të ndershme.”

Gjithashtu Allahu i Lartësuar e ka vënë në dukje ndalimin e ngrënies së pasurisë së jetimit padrejtësisht: **“Mos iu afroni pasurisë së jetimit veçse në mënyrën më të mirë.”** Isra; 10. Gjithashtu thotë: **“Mos i hani pasuritë e tyre duke i përfshirë në pasurinë tuaj. Me të vërtetë kjo është gjëmë e madhe.”** Nisa; 2.

I Dërguari i Allahut a.s. thotë: “Disa njerëz do të ringjallen Ditën e Gjykimit prej varreve të tyre me gojën që u ndizet zjarr.” Dikush tha: “Kush janë këta, o i Dërguari i Allahut?!” Tha: “A nuk e ke parë se Allahu i Lartësuar ka thënë: “Ata që hanë pasuritë e jetimimëve

padrejtësisht do të hanë zjarr në barqet e tyre.” (Nisa; 10).

Nga Ebu Seid Huderiu r.a. përcillet se ka thënë: “Më ka treguar i Dërguari i Allahut a.s. për natën që ka qenë në Isra: “Vura re disa njerëz që i kishin buzët si buzët e devesë. Dikush ishte ngarkuar që t’i kapte prej buzësh dhe të vendoste në gojën e tyre një shkëmb prej zjarri dhe t’ua hidhte atë mbrenda trupit të tyre derisa t’u dilte nga poshtë teksa bërtisnin dhe ulërinin. Thashë: “O Xhibril! Kush janë këta?!” Tha: “Këta janë ata që hanë pasurinë e jetimit padrejtësisht.” (Ibn Xheriri, Ibn Ebi Hatimi).

Sidiu thotë: “Ai që ka ngrënë pasurinë e jetimit padrejtësisht do të ringjallet Ditën e Gjykimit me zjarrin që i del nga goja, veshët, hunda dhe sytë. Të gjithë ata që e shohin do ta njohin se ka ngrënë pasurinë e jetimit.”

Dijetarët thonë: “Çdo kujdestar i një jetimi nëse është i varfër mund të ushqehet me masë nga pasuria e jetimit në varësi të shërbimit, që iu ka bërë interesave dhe nevojave të jetimit, por nëse përfitimi prej pasurisë së tij është më i madh se shërbimi

që i ka bërë, atëherë ajo është pasuri e ndaluar. Argument për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar: “E kush është i pasur le të ruhet (të mos hajë pasurinë e jetimit) dhe kush është i varfër le të hajë me masë.” Përsa i përket domethënies së ngrënies me masë dijetarët kanë mbajtur katër qëndrime: 1- Ajo konsiderohet borxh. 2- Lejohet ngrënia sipas nevojës pa e tepruar. 3- Ngrënia në varësi të shërbimit që i ka bërë jetimit. 4- Ngrënia vetëm në rast nevojë. Këto qëndrime të dijetarëve i ka përmendur Ibn Xheuzi në Tefsirin e tij.

Në Sahihun e Buhariut shënohet, se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Unë dhe kujdestari i jetimit jemi në Xhenet kështu – dhe bëri me shenjë me gishtin e unazës dhe atë tregues.” Të kujdesesh për jetimim do të thotë t’i shërbesh atij dhe t’i plotësosh nevojat, qofshin në ushqim, veshje dhe zhvillim të pasurisë së tij. Në rast se jetimi nuk posedon pasuri, atëherë kujdestari shpenzon nevojat e tij për të fituar kënaqësinë e Allahut të Lartësuar. Në këtë rast nuk bëhet dallim nëse jetimi është i afërmi i tij apo i huaj, si p.sh. nëse për të kujdeset gjyshi, gjyshja, vëllai, nëna,

xhaxhai, burri i nënës së tij, daja apo dikush tjetër nga të afërmit e tij. Ndërsa i huaji është ai jetim me të cilin kujdestarin nuk e lidh asnjë lidhje gjaku. I Dërguari i Allahut a.s. thotë: “Kush e fton një jetim prej muslimanëve në ushqimin dhe pijen e vet derisa Allahu ta bëjë që t’i plotësojë vetë nevojat e veta, atij i përket Xheneti vetëm nëse bën një gjynah që nuk falet.”

Gjithashtu i Dërguari i Allahut a.s. thotë: “Kush e fërkon kokën e një jetimi dhe këtë e bën vetëm për Allahun, për çdo qime që ka prekur dora e tij do të ketë një shpërblim.”

“Kush i bën mirë një jetimi apo jetimeje në kujdestarinë e tij, unë bashkë me të do të jemi kështu në Xhenet.”

Një burrë i tha Ebu Derdasë r.a.: “Më jep një këshillë!” Ebu Derdaja i tha: “Mëshiroje jetimin, afroje pranë vetes dhe ushqej nga ushqimi yt, sepse kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut a.s. t’i thotë një burri, që ankohej për ashpërsinë e zembrës së tij: “Nëse dëshiron të zbutësh zembrën tënde, atëherë afroje jetimin pranë vetes, fërkoja kokën dhe ushqej prej ushqimit tënd, sepse kjo ta zbut zembrën dhe të ndihmon të kryesh nevojat që ke.”

Mos u nervozo!



Mos u nervozo. Nervozizmi i lavdëruar është ai nervozizëm, i cili bëhet atëherë kur nëpërkëmben dispozitat e Allahut, dhe qëllimi i tij është mbrojtja e nderit, nefsit dhe pasurisë, apo për kthimin e një gjëje që është marrë nga i padrejti. I Dërguari i Allahut nuk nervozohet asnjëherë dhe kjo i ndodhte vetëm kur

nëpërkëmbeshin dispozitat e Allahut. Shërimi i nervozizmit dhe mënyrat:

- 1) Heshtja, Muhamedi alejhi selam ka thënë: “Kur nervozohet ndonjëri prej jush le të heshtë”.
- 2) Ulja në tokë, Muhamedi alejhi selam ka thënë: “...Kush e ndien se po hidhërohet le të ulet përtokë”.
- 3) Ndryshimi i gjendjes në të cilën ndodhet njeriu, Muhamedi alejhi selam ka thënë: “Nëse ndokush prej jush hidhërohet dhe është në këmbë le të ulet, nëse i largohet hidhërimi mirë, në të kundërtën le të shtrihet”.
- 4) Marrja e abdesit, Muhamedi alejhi selam ka thënë: “Hidhërimi vjen nga shejtani, dhe shejtani është i krijuar nga zjarri, dhe zjarri shuhet me ujë, e nëse hidhërohet ndonjëri prej jush le të marrë abdes”.
- 5) Të përkujtoj se njeriu që fal ka shpërblim tek Allahu, dhe Allahu i Madhëruar ka thënë: “...dhe kur i hidhëron dikush falin”. Shura 37.

Përshtati: Valdet Kamberi

Tri hadithe Ndalimi i sharjes së erës dhe kohës

Nga Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) transmetohet, se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (alejhis-salatu ues selam) duke thënë: “Era është prej mëshirës së Allahut, e cila vjen me mëshirë ose me dënim. Kur ta shikoni atë mos e shani, por luteni Allahun t’ua sjellë me mirësi dhe kërkojini mbrojtje Allahut nga e keqja, që mund të sjellë.” Ebu Davudi dhe Ibn Maxheh

Nga Xhabir ibn Abdil-lah (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) transmetohet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu uesselam) e vizitoi Ummul-Musejjebin dhe e pyeti: “Çfarë ke kështu o Ummul-Musejjeb që dridhesh dhe rënkon?” Ajo u përgjigj: “Ethem, mos i bekoftë Allahu!” Atëherë Profeti (alejhis-salatu ues selam) tha: “Mos i shaj etem, sepse ato fshijnë mëkatet e bijve të Ademit, ashtu siç largon shakulla e kovacit mbetjet e papastra të hekurit.” Muslimi

Nga Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) përcillet, se i Dërguari i Allahut (alejhis-salatu ues selam) ka thënë: “Allahu i Lartësuar ka thënë: “Më lëndon Mua biri i Ademit kur e shan kohën dhe Unë jam vetë koha. Në dorën Time është e gjithë çështja, e shndërroj natën dhe ditën.” Buhariu dhe Muslimi

Shoqëri / Aborti problem social dhe mëkat hyjnor

Nga hoxhë Ervin Qylafku

Jeta është një dhuratë shumë e çmuar që Allahu xh.sh. i ka dhënë njeriut dhe po ashtu një vijim i nderimit prej Tij. Zoti i Lartësuar thotë në suren Isra: "Në të vërtetë Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit". Në të njëjtën kohë, Islami si fe universale, që i përket cdo kohe dhe vendi, mbron me fanatizëm pesë principe themelore pa të cilat jeta nuk do të kishte kuptim. Një ndër principet kryesore është ruajtja e jetës. Islami e konsideron atë të shenjte prandaj ai ndalon çdo formë apo mënyrë që atakon, ose kërcënon jetën e njeriut. Allahu xh.sh. në suren Maide na tregon, se ai që bëhet shkak për humbjen e një jete pa të drejtë është njëllor sikur ka vrarë të gjithë njerëzimin. Një nga mënyrat e abuzimit me jetën është aborti, fenomen ky shumë shqetësues i shoqërisë sonë. Ai lidhet ngushtë gjithashtu me atë që quhet "planifikim familjar", si dhe me propagandimin e saj. Një pjesë e njerëzve, duke u nisur nga ideja që çdo pjesëtar i ri që vjen në familje është barrë dhe shqetësim nga këndvështrimi ekonomik, ndërmarrin veprime të cilat shpesh nuk iu shkojnë përshat edhe ndjenjave të tyre. Edhe kjo gjithashtu bie ndesh me besimin, se Allahu i Lartësuar është furnizuesi dhe garantuesi i jetës së tyre me të gjitha kërkesat e saj. Ai thotë në suren Isra: "Mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë. Ne u sigurojmë ushqim atyre dhe juve. Vërtetë vrasja e tyre është gjynah i madh". Gjithashtu Profeti a.s. pasi tregon etapat e krijimit të fetusit në mitër thotë, se Allahu dërgon një melek i cili ndër të tjera cakton (me lejen e Zotit) rrizkun e kësaj krijese gjatë gjithë jetës së tij. Planifikimi familjar ose kufizimi i numrit të lindjeve është ide e importuar, e cila nuk njihej para disa dekadash nga shoqëria jonë. Ajo ka lindur në Evropë në shekullin e 18-të dhe i pari që e propagandoi atë ishte një prift anglez në një prej artikujve të tij

të shkruar me titullin: "Shtimi i numrit të banorëve dhe ndikimi i tij në evoluimin e shoqërisë". Në këtë artikull ai pretendon, se pasuritë e natyrës nuk i plotësojnë nevojat e numrit të madh të banorëve të tokës dhe për këtë arsye mbarë njerëzimi do të përballet me fatkeqësi të shumta, ku kryesorja do të jetë uria. Dalja nga kjo situatë e disfavorshme për njerëzimin është planifikimi familjar dhe/ose kufizimi i numrit të lindjeve. Ky slogan nuk u pajtua me shoqëritë e asaj kohe, të cilat shprehnin shqetësimin e tyre në lidhje me praktikimin e tij. Këto shqetësime i hasim edhe sot. Nga pasojat e kultivimit të kësaj ideje te njerëzit është shtimi i numrit të aborteve dhe ulja e lindjeve nga viti në vit. Në vendin tonë p.sh. duke iu referuar të dhënave të viteve 1993-1994, kur një familje kishte minimalisht 3 apo 4 fëmijë, sot një çift preferon të ketë një apo dy. Gjithashtu sipas një studimi të kryer nga Instituti i Shëndetit Publik ka rezultuar, se gjatë vitit 2009 janë kryer 9100 aborte. Ndërsa sipas studimeve të bëra nga USAID-i, përllogariten 230 aborte në 1000 lindje, ndërkohë që në vende të tjera të Evropës përllogariten vetëm 28 në 1000 lindje, ndërsa vendi vazhdon të ketë një nivel të ulët të lindshmërisë. Tabela dinamike tregon të dhënat e mëposhtme:

| Viti | Shtatzani | Lindje | Aborte (numër) | Aborte në % të shtatzanive | Lindje / Abort | Aborte spontan | % aborte spontan | Aborte me ndërprerje të vullnetshme | % Aborte me ndërprerje të vullnetshme |
|------|-----------|--------|----------------|----------------------------|----------------|----------------|------------------|-------------------------------------|---------------------------------------|
| 2000 | 70,312 | 53,192 | 17,120 | 24.35% | 3.1 : 1 | 7,251 | 42.35% | 9,869 | 57.65% |
| 2001 | 68,588 | 52,888 | 15,700 | 22.89% | 3.4 : 1 | 5,735 | 36.53% | 9,965 | 63.47% |
| 2002 | 59,476 | 45,515 | 13,961 | 23.47% | 3.3 : 1 | 5,205 | 37.28% | 8,756 | 62.72% |
| 2003 | 59,099 | 47,012 | 12,087 | 20.45% | 3.9 : 1 | 5,197 | 43% | 6,890 | 57% |
| 2004 | 53,539 | 43,022 | 10,517 | 19.64% | 4.1 : 1 | 5,106 | 48.55% | 5,411 | 51.45% |
| 2005 | 49,015 | 39,612 | 9,403 | 19.18% | 4.2 : 1 | 4,756 | 50.58% | 4,647 | 49.42% |
| 2006 | 43,781 | 34,229 | 9,552 | 21.82% | 3.6 : 1 | 5,039 | 52.75% | 4,513 | 47.25% |
| 2007 | 42,193 | 33,163 | 9,030 | 21.4% | 3.7 : 1 | 4,954 | 54.86% | 4,076 | 45.14% |
| 2008 | 44,586 | 36,251 | 8,335 | 18.69% | 4.3 : 1 | 4,408 | 52.89% | 3,927 | 47.11% |
| 2009 | 37,328 | 29,189 | 8,139 | 21.8% | 3.6:1 | 4,575 | 56.21% | 3,554 | 43.67% |

Ekzistojnë një sërë shkaqesh që i detyrojnë nënat të ndërpresin shtatzëninë, si prirja e tyre për t'iu përkushtuar më shumë karrierës, shtatzënitë para martesore etj. Por ato që mbeten më të rëndësishmet janë varfëria, lehtësimi nga detyrimet, numri i madh i fëmijëve, si dhe arsyet shëndetësore.

GJYKIMI MBI ABORTIN

Duke iu referuar etapave që kalon fetusit në mitër dhe gjithashtu procesit të futjes së shpirtit në fetus, gjykimi mbi abortin ndryshon para hyrjes së shpirtit dhe pas tij. Juristët muslimanë kanë mendim unanim (ixhma), që shpirti i futet fetusit pas 120 ditëve nga bashkimi i qelizës së mashkullit dhe të femrës. Edhe pse me anën e aparateve moderne mund të shikohen disa lëvizje, ato konsiderohen si të pavullnetshme dhe nuk tregojnë që fetusit është krijuar me shpirt. Atëherë duke u nisur që në momentet e para të një shtatzënie e deri afër momentit të futjes së shpirtit në fetus, pjesa më e madhe e juristëve muslimanë janë të mendimit, që ndërprerja e shtatzënisë nëpërmjet abortit është e papëlqyer. Ndërsa në rastet që vihet në rrezik shëndeti i nënës ose jeta e saj, ai bëhet i nevojshëm ose i domosdoshëm sipas rastit. I bashkëngjiten këtij gjykimi rastet e shtatzënisë së padëshiruar, si pasojë

e përdhunimit, ose kur fetusit është i zhvilluar, si pasojë e mutacioneve, kur nëna është mbartëse e virusit HIV siç thekson Akademia Ndërkombëtare e Fikhut Islamik, ose e viruseve të tjera të transportueshme dhe të rrezikshme për jetën etj. Ndërsa për sa i përket fazës pas futjes së shpirtit aborti nuk është i lejuar dhe ky veprim konsiderohet vrasje me pa të drejtë. Këtu përjashtohen disa raste specifike, si p.sh. kur me anë të abortit ruhet jeta e tij pasi ajo bëhet e pamundur nëse do të qëndrojnë në mitër të nënës se tij, ose në rastet kur nëna vdes dhe fëmija është akoma i gjallë. Gjithashtu aborti nuk lejohet edhe nëse bëhet e qartë që fëmija do të lindë me pasojë shëndetësore qofshin këto sëmundje gjymtyrësh ose mendore. Gjithashtu nëna që i nënshtrohet abortit me vullnetin e saj të lirë duhet të paguajë si kompensim 212,5 gr. ar të pastër ose vleftën e tij. Kjo masë është një e njëzeta e kompensimit që paguhet për vrasjen e njeriut të rritur, ashtu siç tregohet në hadithet profetike. Krahas kësaj nëna duhet të agjërojë dy muaj rresht, sepse ajo është bërë shkak për vrasjen e një krijese të gjallë pa të drejtë. Sot shumica e njerëzve e konsiderojnë abortin si një çështje të papërfillshme, por nuk duhet të harrojnë, se ai është problem social dhe gjithashtu mëkat hyjnor.

Cikli i haditheve të dobëta dhe të trilluara

Nga hoxhë Mustafa Tërniqi

Në numrat e kaluar kemi folur për ndëmin dhe rrezikun e haditheve të dobëta dhe të trilluara në mesin e muslimanëve, ku kemi përmendur dhe përhapjen e këtyre haditheve në shkallë të gjerë në literaturën islame shqipe. Gjithashtu kemi cituar se redaksia e kësaj gazete do të fillojë një cikël të posaçëm për klasifikimin dhe dallimin e haditheve të dobëta dhe të trilluara, veçanërisht ato hadithe ku mbështeten dhe kërkohen të lulëzojnë shumë sekte dhe rryma të devijuara nga Islami i pastër, të cilët nuk mjaftohen veç me predikimin e ideve të tyre, por përpiqen edhe me botimin e librave të ndryshëm. Ndër ta është dhe sekti Shiit, i cili bën përpjekje të vazhdueshme për t'u integruar në mesin e muslimaneve suni me botime të ndryshme. Një prej këtyre botimeve kemi librin: 110 VIRTYTE TË IMAM "ALIUT", Përgatitur nga Edin Q.Lohja dhe botuar nga: Biblioteka "Zemra e Traditës", nr 2. Me këtë libër synohet të ngrihet kulti i individit, ku flitet veç për vlerat e Aliut, që nënkuptojnë se ai është njeriu më i dashur, më i mirë dhe më i devotshëm nga të gjithë shokët e Profetit a.s. Jo vetëm kaq por nëpërmjet këtij libri synohet të besohet se Aliu duhet të ishte

Kalifi i parë i muslimanëve, ai është dera e vetme e udhëzimit dhe e shpëtimit dhe kjo duhet trashëguar kështu pas vdekjes së tij nga familja e tij, dhe se ata janë të vetmit që e kuptojnë të drejtën dhe të vërtetën, duke zbehur kështu gradualisht figurën e Ebu Bekrit, Omerit, Osmanit dhe sahabëve të tjerë të ndershëm. Ndërkohë shumica e këtyre haditheve janë të dobëta dhe shumë prej tyre të trilluara.

Hadithi nr 1: Transmetohet nga Omer ibn el-Khattabi, se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Asnjëri nuk mund t'i afrohet virtyteve të Aliut, ai e shpie shokun e vet në udhërrëfim dhe e largon atë nga humbja." (E ka përcjellur Taberaniu).

Grada e hadithit: Këtë hadith e transmeton Taberaniu në "Mu'xhemin e mesëm" nr. 4726 dhe në "Mu'xhemin e vogël" nr. 676 dhe në zinxhirin e transmetuesve gjendet Abdurrahman ibn Zejd ibn Eslemi për të cilin Imam Ibnul Xheuzi thotë: "E kanë bërë të dobët të gjithë muhadithinët". Madje imamët e mëdhenj si Buhariu, Ali Ibn Medini, Nesaiu, Ebu Hatim Errazi etj., e konsiderojnë tepër të dobët. Kurse imam Hakimi dhe Ebu Nuajmi thonë, se ky transmetues përcjell hadithe të trilluara.

Hadithi nr 2: Ibn Abasi ka thënë: "I Dërguari i Allahut ka thënë: "Kushdo që

dëshiron të jetojë jetën time, të vdesë vdekjen time, e të banojë në Xhenetin e Përjetësisë të mbjellur nga Zoti im, atëherë le të marrë për kujdestar (vali) Aliun dhe trashëgimtarët e tij, dhe le të pasojë imamët (që do vijjnë) pas meje, sepse ata janë pasardhësit e mi (itreti): Ata janë krijuar nga brumi im dhe janë pajisur me të kuptuar me dije. Ndaj, mjerë ata nga umeti im që ua mohojnë meritat dhe me këtë ndahen prej meje! Allahu mos ua dhashtë ndërmjetësimin tim!

Grada e hadithit: Këtë hadith e transmeton Ebu Nuajmi në "Hiljetul-eulija" 1/86 dhe në zinxhirin e transmetuesve gjenden Abdurrahman ibn Imran ibn Ebi Lejla dhe Ja'kub ibn Musa el-Hashimi, të cilët janë transmetues të panjohur dhe për rrjedhojë nuk u merret për bazë transmetimi.

Hadithi nr 3: Hakimi në "El-Mustederek alessahihajn" thotë: "Është transmetuar nga një numër i bollshëm burimesh (tevaturo) nëpërmjet se Fatime bint Esedi e lindi Prijësin e Besimtarëve Ali ibn Ebi Talibin brenda Qabes."

Grada e hadithit: Fjala e Hakimit bie në kundërshtim me transmetimet e vërteta që kanë ardhur, sepse nuk është aspak e njohur tek dijetarët e hershëm dhe as në transmetimet e ndryshme, që Aliu ka lindur brenda Qabes. Ndërkohë ajo që njihet

gjerësisht në transmetimet e sakta është se Hakim ibn Hizami është ai që ka lindur brenda Qabes, siç transmeton Muslimi në Sahihun e tij dhe të tjerë. Madje vetë Hakimi në Mustedrekun e tij transmeton fjalën e Mus'ab ibn Abdullahut, i cili thotë se Hakim ibn Hizami është ai që ka lindur brenda Qabes dhe askush tjetër para dhe pas tij. Ndërsa imam Muglatai në "Ikmal Tehdhibil Kemal" 4/120 përcjell fjalën e imam Ibnul Xheuzit, i cili thotë: "Pretendimi i atyre që thonë se Aliu ka lindur brenda Qabes nuk është i saktë, sepse brenda saj s'ka lindur askush tjetër përveç Hakim ibn Hizamit."

Hadithi nr 4: "I Dërguari i Allahut citohet t'i ketë thënë Hazreti Aliut: "O Ali! Pozita jote është si ajo e Qabes. Njerëzit shkojnë tek Qabeja, por ajo shtëpi e madhërishtme nuk i afrohet kurrë askujt. Ndaj nëse pas vdekjes sime, njerëzit vijnë tek ti dhe të japin betimin e besnikërisë (bejat) pranoje, e nëse nuk vijnë, atëherë ti mos shko tek ata."

Grada e hadithit: Këtë hadith e transmeton Ibnul Ethiri në "Usdul-Gabeh fi Marifetis-sahabe" 4/31 dhe në zinxhirin e transmetuesve ndodhen Muhamed ibn Zekerijja el-Galabi për të cilin imam Darekutni thotë: "Ka qenë trillues i haditheve profetike" dhe El-Abas ibn Bekar për të cilin imam Khatibul Bagdadi thotë: "Ka qenë gënjeshtar".

Kulturë / Hamami dhe kultura e të larit në botën muslimane

Nga Roald A. HYSA

Në të gjitha qytetet muslimane e gjen edhe hamamin, si një shenjë dalluese e këtij qytetërimi. Islami i kushton një vëmendje të veçantë pastërtisë trupore sidomos në çaste të veçanta. Banjat publike hasen edhe në qytetërimi të tjera më të hershme, si në lindje të kinëzët po ashtu edhe në Perëndim të Romakët, e po ashtu edhe në vendet e veriut me saunat dhe banjat ruse. Hamamin ose banjën publike e gjen si një ndërtesë të veçantë dhe funksionale në të gjitha qytetet muslimane gjatë të gjitha kohëve e deri më sot. Sipas madhësisë mund të kishin edhe më shumë se dy hamame (në rast se qyteti kishte dy ose më tepër hamame, njëri përdorohej vetëm nga gratë), por hamami gjendet edhe në ndërtime private. Përdorimi i hamameve bëhej me radhë, fillimisht përdorohej nga burrat e më pas nga gratë (fëmijët meshkuj pa mbriritur moshën madhore futeshin së bashku me gratë). Në hamam kemi edhe enët e sapunit, të cilat ishin çanta prej metali, në formë ovale, poshtë me vrime si kullësë dhe sipër me një dorëz. Brenda saj kishte disa ndarje si kuti, ku vendosej sapuni, krehëri, djezat e fërkimit, sapunimit dhe fjet. Një person që shkante në hamam për t'u larë fillimisht pushonte pak e qetësohej në një dhomë, që njihet

si dhoma e ngrohjes dhe që ngrohet vazhdimisht nga një rrymë e nxehtë ajri, e cila të lejon të marrësh frymë lirisht. Personi lëviz më pas në një dhomë më të nxehtë se e para, që njihet si dhoma e nxehtë, ku më parë e kanë spërkatur trupin me ujë të ftohtë. Pasi lahet trupi krejtësisht dhe kryhet një masazh personi lëviz për në dhomën e freskët dhe qëndron aty për një periudhë qetësimi.

Struktura arkitektonike e hamamit pra, në elementet e saj më të thjeshta, përbëhet nga një sallë pushimi apo veshjeje, në një tjetër dhomë të freskët, ku bëhen kontaktet e para dhe të fundit me ujin e freskët, në një sallë qendrore më të ngrohtë, në të cilën është e mundshme të rrih më gjatë dhe me një sallë të mbrame në fund, ku avulli nxit djersitjen dhe në të cilën duhet të veshësh pantofla për të mos djegur këmbët. Në anët e kësaj salle, në vende më pak të nxehta, frekuentuesit e hamamit përgatiteshin për larjen e kokës, masazhin etj. Arkitektura e hamamit turk është e ndikuar gjerësisht nga termat romake. Ndërsa në shtëpitë private, hamamet i gjeje brenda shtëpisë dhe komunikohej vetëm nëpërmjet dhomës së gjumit, ku flenin çiftet e martuara, të cilët merrnin gusul menjëherë pasi kishin kryer marrëdhëniet seksuale. Pra, që të mos merreshin vesh nga pjesa tjetër e familjes. Në këtë pjesë të shtëpisë, hamami përdorej

vetëm për të kryer larjen dhe në ndryshim nga ditët e sotme, nuk kryhen nevojat e tjera, madje kanë qenë xhelozisht të ndara. Brenda hamamit kishte një lambik të madh, gryka e të cilit kalonte nëpërmjet një mangalli me prush që e nxehte ujin me të cilin do të laheshe. Nuk ka qytet që të mos gjeje hamamet, gjithashtu edhe në të gjitha trojet shqiptare. Shumë domethënëse është edhe historia e fillimeve të Tiranës si qytet, kur Sulejman pashë Bargjini (Mulleti), që njihet si themeluesi i saj, ndërtoi xhaminë që mbante emrin e tij, hamamin dhe furrën e bukës. Pra, tre elemente themelore për qytetërimin, xhamia si vendadhurimi që i mbledh njerëzit në një vend, hamami si simbol i pastërtisë së detyrueshme, si dhe furra e bukës që u duhet njerëzve për t'u ushqyer. Kështu që hamami në arkitektonikën qytetare islame shihet si një element themelor qytetëruar. Të laheshe në hamam nuk është thjesht një procedurë pastrimi fizik, por në më të shumtën e rasteve është edhe një akt përkushtimi. Pastërtia dhe kujdesi për trupin në shoqëritë islame janë të rregulluara nga norma që i përkasin jetës së përditshme, me veprimet e saj të zakonshme të pastërtisë dhe që disiplinohen më tutje hapësirën e pastrimit që përbëhet nga banjat. T'i drejtohesh hamamit dhe të laheshe i tëri bëhet e detyrueshme goftë në rrethana të jashtëzakonshme, si

në rastin e përgatitjes për t'u martuar, si edhe në rrethana të zakonshme pas menstruacioneve apo marrëdhënies seksuale (marrja gusul). Hamami mund të konsiderohet edhe si një pjesë e rëndësishme e sferës së jetës shoqërore qytetare të shekujve të shkuar.

Disa ndërtesa hamamesh janë ruajtur edhe sot si objekte antike, fjala vjen në Elbasan, Krujë, Prizren, Shkup, Vushtri etj. Për nga numri i madh i hamameve në qytete të botës muslimane dallojnë Kajro, e cila ka pasur rreth 300 hamame, ndërsa për Damaskun thuhej se ka pasur 365 hamame, nga një për çdo ditë nga të cilët në vitin 1950 kishin mbetur rreth 50 copë të tilla.

Nga një vështrim i shpejtë i hedhur në librin "Shqipëria dhe Shqiptarët" të Sami Frashërit në të gjithë zërat, ku flitet për qytetet shqiptare dhe të dhënave të tyre do të vërehet, se ato e kanë pasur një hamam të paktën. Qytetet e mëdha shqiptare kanë pasur dy edhe tre hamame, ku mund të përmendim këtu Shkodrën, që ka pasur dy hamame dhe njëri ka qenë vetëm për gra.

Kultura e hamamit dhe e larjes vazhdon të jetë e gjallë në shumë vende të Ballkanit, po ashtu është e përhapur gjerësisht edhe në Perëndim, e kryesisht sot e gjen atë si pjesë e industrisë së turizmit të këtyre vendeve.

Sekretarja dhe problemet bashkëshortore

Nga hoxhë Bledar T. Haxhiu

Një problem të madh kalojnë sot shumë familje shqiptare, dhe jo vetëm ato. Ajo është përhapur aq shumë, saqë tashmë është bërë modë dhe kriter pune; por në të njëjtën kohë është kthyer në një shqetësim të përditshëm për shumë familje, të cilat si shkak i pranisë së saj kalojnë momente të vështira, ose janë në prag të humerës. Kjo është më specifike tek nëpunësit (drejtorë, z/ministra...) apo dhe tregtarë e pronarë agjencish të ndryshme.

Në realitet kjo temë nuk është thjesht për të mbushur rreshtat e një gazete, por është një shqetësim i përditshëm i shumë familjeve (edhe pse shpesh herë ato nuk shfaqen jashtë mureve të apartamenteve).

Shpesh herë nëse shkon në zyrat e punës, gjen se nga kriteret bazë në shumicën e tyre është dhe fakti, apo kriteri i të qenit vajzë, me moshë të caktuar dhe me arsim përkatës.

Kjo është pikënisja e problemit të shumë familjeve dhe një shkak më shumë për rritjen e degjenerimit në shoqëri. Gjen jo rrallë herë gratë të cilat fillojnë e i shtrajnë një mori pyetjesh bashkëshortëve të tyre, ndërkohe që vullkani i zjarrtë vlon brenda tyre, pasi ata tashmë kanë marrë në zyrë një sekretare. Ajo në realitet ka vënë re ndryshime në sjelljen e burrit të saj, ndaj dhe me të drejtë pyet e shqetësuar dhe e habitur.

Ajo e njeh mirë burrin e saj, dje ai shkante në punë me vonesë, ndërsa pas ardhjes së sekretares ka filluar zgjohet dhe del herët për në punë! Tashmë ka filluar të interesohet më shumë për pamjen e tij, vishet më këndshëm se dikur dhe ka filluar të vendos edhe parfum butiku! Madje edhe kafënë që e pinin bashkë para se të shkante në punë, ndoshta ka filluar ta pijë me sekretaren, kështu mendon ajo dhe është e natyrisht, sepse djalli lëviz tek njeriu si gjaku nëpër damarë, me të vërtetë ashtu sikurse ka thënë edhe Profeti Muhamed.

Kjo gjendje e vë gruan në stres, fillon të mos ketë më kujdesin e dikurshëm për shtëpinë. Ajo është në hall të madh, i cili e ka shpërqendruar fare, sepse ajo ka frikë se dikush tjetër ka hyrë në pjesën e saj dhe se mund të humbë bashkëshortin!!

Shumë biznesmenë apo pronarë agjencish mendojnë se punësimi i një femre në këtë biznes do t'u sjellë më shumë klientë, ndaj dhe shpesh përpiqen të jenë sa më të pashme. Ata në fakt harrojnë se riziku është në dorë të Zotit, por nga ana tjetër ai ndoshta po rrezikon atë që është më e shtrenjtë se çdo gjë tjetër "familjen". Profeti Muhamed thotë në një nga thëniet e tij: "Nuk vetmohet një burrë me një grua (jo të familjes), e të mos jetë djalli i treti i tyre".

Disa punësojnë femra me pretekstin, se janë krah më i lirë pune, por ai nuk vëren humbjen, e cila nuk duket në horizont por që mund t'i kushtojë më shtrenjtë se ato që kishte menduar, aq sa ai tashmë do të shihet me syrin e dyshimit dhe shfrytëzimit jo vetëm nga bashkëshortja e tij, por në një rreth edhe më të gjerë. Çdo familje kërkon jetë të lumtur, të qetë dhe pa probleme, atëherë përse vallë ky bashkëshort i hap portën së keqes, përse bëhet shkak i shqetësimeve të familjes? Përse vallë për shkak të epshit të tij të shfrenuar ai humb atë që ndoshta e ka ndërtuar me shumë mundim (familjen).

Ka dhe të atillë, që me marrjen e sekretareve apo vajzave në agjencitë e tyre, nuk kanë thjesht qëllim punësimin, por shfrytëzimin e tyre, ndaj dhe ky është një apel për të gjithë vajzat dhe prindërit, të cilët ende e kanë nderin prej gjërave të tyre parësore. Allahu nuk vendos begati tek ata njerëz, të cilët përpiqen të veprojnë gjëra që dalin jashtë natyrës së vendosur prej Tij.

Kështu që sekretarja do të mbetet gjithmonë një rrezik dhe kërcënim për familjen, një shkak për degjenerim dhe arsye për shturje...

"Pakti Nama" dhe Muhamed Fatihu

Nikica Vojica kalon ditët e tij në kishën e Shpirit të Shenjtë në qytezën boshnjake Fonica. Kjo kishte shërben si strehë për priftërinjë katolike françeskanë prej disa qindra vitesh dhe meritën për këtë e ka një ferman historik që quhet Pakti Nama. Ai është një ferman osman që e ka nxjerrë sulltani osman Muhamed Fatihu drejtuar atit françeskan Angelo Svicović para 550 vjetësh. Priftërinjë françeskanë janë krenarë që e kanë trashëguar këtë pakt prej shekujsh.

"Të krishterët françeskanë kanë mbi jetuar në këto troje falë këtij dokumenti të quajtur "Pakti Nama" dhe falë urtësisë së thellë të Muhamed Fatihut dhe atit Angelo. Edhe pse ndonjëherë osmanët nuk i janë përmbajtur këtij pakti, ne gjithsesi e kemi arritur që ta mbajmë dhe ta ruajmë atë" – thotë prifti françeskan Nikica Vojica.

Ky ferman doli në një kohë trazirash dhe kur skllavëria ishte përhapur në masë dhe feudalizmi ishte regjimi në fuqi, për këtë arsye përmbajtja e këtij fermi përkon mesë miri me konceptin e të drejtave të njeriut për atë periudhë.

"Le të qëndrojnë në trojet e tyre...as unë, as ndonjëri nga vezirët e mi, familjarët e mi, ndonjë nga vartësit e mi, shërbëtorët e mi dhe as ndonjë qytetar i parandorisë sime nuk ka të drejtë që t'i lëndojë ata, apo t'i kërcënojë jetën dhe pronat e kishës së tyre" - thuhet në fermanin të nënshkruar nga Muhamed Fatihu. Qyteti që mban në gjirin e tij Paktin Nama sot mban në gjirin e tij muslimanë dhe të krishterë dhe pavarisht luftës që përfshiu Bosnjën në fillimvitet nëntëdhjetë ende mbizotëron respekti i ndërsjellë mes tyre.

Al Jazeera



Ekonomi / Rregullat themelore të Ekonomisë Islame mbi pronën

Nga P.P. Abdul-Rrezaku

Islami e postulon teorinë e tij ekonomike dhe filozofike me orientim kozmologjik. Është një fakt kozmik që universi dhe të gjitha qeniet e gjalla dhe jo-të gjalla brenda tij i binden ligjeve të pandryshueshme të Krijuesit të vet. Kështu Islami i kërkon qenies njerëzore të jetë në mirëkuptim me natyrën dhe universin, duke ia dorëzuar vullnetarisht dëshirën e vet vullnetit dhe ligjit të Zotit, në sferën e jetës ku ai shijon lirinë. Kështu Islami përkufizohet si një lëvizje arre. Që të dy termat kalif (mëkëmbës), i nxjerrë nga Kurani i Shenjtë me qëllim që të përkufizojë dhe përshkruajë statusin dhe pozicionin e qenies njerëzore në këtë botë dhe fjala Kalifat (mëkëmbësi) e përdorur për të paraqitur sistemin social dhe ekonomik simbolizojnë nevojën e bindjes së pakushtëzuar vetëm ndaj Allahut, dhe në pajtim me ligjet dhe rregullat e Tij. Termi i kalifit (mëkëmbësit) nënkupton bindjen e qenies njerëzore ndaj Allahut si një person, një shoqëri dhe një shtet në termat e statusit si një mëkëmbës i Allahut dhe kjo i përgjigjet përkufizimit të vërtetë të Islamit dhe asaj që e pason atë. Është e njëjta terminologji e mëkëmbësisë,

që Kurani i Shenjtë e ka përdorur me qëllim që të përkufizojë marrëdhënien ndërmjet qenies njerëzore dhe Allahut në sferën e pronës dhe marrjes së saj. Nga këndvështrimi islam qeniet njerëzore nuk kanë pronësi në pronat e vet, qofshin ato individuale, ose shtetërore, ose shoqërore. Kjo perspektivë i përgjigjet natyrës së jetës njerëzore në këtë planet. Qeniet njerëzore nuk sjellin asgjë me vete kur ato lindin dhe nuk marrin asgjë me vete kur ato vdesin. Qenia njerëzore nuk ka pronësi qoftë edhe të jetës, trupit apo shpirtit të vet. Si ka mundësi që një qenie e tillë, që nuk ka pronësi të vetë qenies së vet dhe jetës mund të pronësojë diçka, që as nuk i përket atij. Kështu nga këndvështrimi islam, asnjë individ, apo shoqëri, apo shtet nuk e ka të drejtën e pronësisë absolute mbi pronën. Islami e ripërkufizon marrëdhëniet ndërmjet qenies njerëzore dhe pronës nga një nivel i ndryshëm. Le të meditojmë pak mbi dy vargjet e Kuranit Madhështor të cituara më poshtë:

“Besoni Allahut dhe të dërguarit të Tij dhe jepni nga ajo që Ai u bëri trashëgues (mëkëmbës) në të, se ata që besuan prej jush dhanë për hir të Zotit, ata kanë shpërblim të madh.” Hadidë 7. Ky ajet

nënkupton dhe përfshin gjërat në vijim: Pronari i vërtetë dhe absolut i pronës dhe i pasurisë është Allahu, që është Krijuesi dhe Pronari i Universit dhe i qenieve njerëzore. Qeniet njerëzore nuk kanë ndonjë status dhe/ose pozicion tjetër nga ai i mëkëmbësisë në sferën e ekonomisë gjithashtu. Qenia njerëzore përfaqëson Allahun gjithashtu edhe në veprimtarinë e tij ekonomike. Kështu qenia njerëzore është përgjegjës t'i bindet dhe të pajtohet me ligjet, rregullat dhe bazat e Allahut në sferën e veprimtarisë së tij ekonomike po ashtu. Dhunimi i ndërgjegjshëm i këtyre gjërave do të ishte në kundërshtim me konceptin e Teuhidit (Monoteizmit), si na përkufizohet dhe na përshkruhet në Kuranin Madhështor dhe që nënkupton dorëzimin e vullnetshëm nga qenia njerëzore ndaj vullnetit të Zotit. Le të shohim ajetin e dytë nga Kurani Madhështor:

“Mendjelehtëve (të papjekurve) mos u jepni pasurinë tuaj që Allahu e bëri për ju mëkëmbje...” Nisa 5. Ky ajet nënkupton dhe përfshin gjërat në vijim: Për aq sa mund të jemi të interesuar për pronën shoqëria njerëzore ka përgjegjësi kolektive. Përsëritja tri herë e formës së shumësit të personit të dytë në këtë ajet

(bëhet fjalë për ajetin në arabisht) ka të bëjë me shoqërinë dhe me atë që drejton punët e saj. Prona është baza e mbijetesës së jetës njerëzore në këtë planet. Në këtë parim të respektuar entiteti (individ, grup individësh apo shoqëria), i cili bëhet administratori i një prone çfarëdo ka marrë të drejtën private mbi të dhe për pasojë fuqinë për të arritur marrëveshje për të. Ky vullnet do të ekzekutohet nga entiteti përgjegjës nën mbikëqyrjen kolektive dhe të rreptë të shtetit islam apo sistemit shoqëror përkatës.

Nëse e drejta e privilegjit të përfaqësuesit privat dhunon rregullat dhe normat themelore, dhe i bezdis çështjet e ndryshme sociale do të nevojitej ndërhyrja e shtetit islam, me qëllim korrektimin dhe vënien në rrugë të drejtë, kështu që t'i shërbejë synimeve në një shkallë më të gjerë të sistemit shoqëror dhe ekonomik të Islamit. Kur i konfirmojmë që të dy ajetet e cituara më sipër dhe i bashkëlidhim ato, ligjet themelore ekonomike që mund të deduktohen nga ato janë: Privilegjet e entitetit (individ, grup individësh apo shoqëria), që ka mbi pronën me të cilën merren, janë ato të një administratori nën mbikëqyrjen e rreptë dhe kolektive të shoqërisë apo shtetit.

Finesa në zbatimin e sunetit

Nga Muhamed bin Ibrahim el Hamed

Lexova një fjalë të dijetarit të nderuar Muhamed bin Uthejmin në komentin e tij bërë librit “El Mumti” 3/90 ku thoshte: “Nuk duhet që njeriu të zbatojë një sunet duke lënduar me të njerëz të tjerë.”

Kjo është një fjalë e bukur, që buron nga një dijetar i nderuar dhe që ngërthen në vetvete domethënie edukative në zbatimin e sunetit profetik. Prandaj përmbajti zbatimin të sunetit, sepse ndjekja e shembullit të krijesës më të mirë, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, është një virtyt i vlefshëm dhe një sjellje e lartë përmes së cilës mund të arrish në grada të larta dhe të afrosh me Allahun e Lartësuar. Sa më shumë të rritet kujdesi për zbatimin e sunetit aq më afër perfeksionit do të jesh.

Por duhet patur parasysh diçka me shumë rëndësi, që ka të bëjë me shijen në zbatimin e sunetit, në mënyrë që zbatimi i këtij të fundit të mos përdoret si justifikim për të lënduar të tjerët dhe as për t'i larguar njerëzit nga feja. Ndër shembujt mund të përmendim përdorimin e misvakut, që është prej rrugës profetike dhe një vepër e shpërblyeshme, por nuk duhet që me këtë vepër të lëndohen të tjerët, duke nxjerrë tinguj të bezdisshëm apo lëvizje shqetësuese.

E njëjta gjë mund të thuhet për haxhin, si p.sh. hedhja e gurëve apo puthja e Gurit të Zi dhe të gjitha adhurimet e tjera, që shkaktajnë grumbullimin e njerëzve. Në të tilla situata duhet që besimtari ta ndiejë shpirtin e adhurimit dhe të vejë në zbatim vëllazërinë islame, ku në të njëjtën kohë

të zbatojë sunetin dhe të kujdeset për të drejtat e vëllazërve të tij muslimanë. Në të tilla raste muslimani duhet të përpiket të dëshirojë për ta atë që dëshiron për vete, të urrejë për ta atë që urren për vete dhe nëse zbatimi i sunetit shkakton lëndimin e tyre, atëherë moszbatimi i tij është më parësor.

Në rastin e drejtimit të rreshtave në namaz do të shohësh se disa njerëz e teprojnë duke lënduar ata që kanë përkrah me justifikimin e bashkimit të kërcirrit të këmbës dhe shpatullave, madje në disa raste disa prej tyre e shikojnë me vër vëllain e tyre përkrah dhe në disa raste edhe e kritikojnë, nëse shohin që vëllai i tyre nuk reagon ndaj kërkesës. Në rastin e hapësirave bosh kjo është një vepër e lavdërueshme, por ndonjëherë dikush bën përpara tek rreshti që ka përballë, që nuk ka hapësira dhe zë ngushtë njerëzit që ka përpara dhe i lëndon ata derisa t'i hapin një vend.

Nuk ka dyshim se drejtimi i rreshtave plotëson namazin, por nuk është e pëlqyeshme, që namazi të plotësohet duke krijuar zemëratë dhe as duke larguar zemrat, por duke u sjellë butë dhe me finesë. Namazi nuk mund të plotësohet duke rrënuar një qëllim kryesor prej qëllimeve të tij, kur falet me xhemat, dhe që është afrimi i zemrave dhe shtimi i dashurisë. Kështu veprojnë edhe disa imamë, të cilët dëshirojnë të drejtojnë rreshtat në xhamitë e tyre – dhe për këtë duhe përgëzuar- por mirë do të ishte që kjo të realizohej shkallë-shkallë duke marrë parasysh gjendjen e xhematit, sidomos

gjendjen e të moshuarve dhe udhëtarëve.

Një shembull tjetër është dhënia e selamit. Disa vëllazër e japin selamin, por kjo ndonjëherë shoqërohet me një vrazhdësi, mbledhje të fytyrës dhe me një tingull të ashpër, sa disa muslimanë do të dëshironin që ai të mos e kishte dhënë fare selamin. Nëse selami do të shoqërohej me një buzëqeshje të ndritshme, me qetësi dhe me një zë të butë do të kishte qenë edhe më i dobishëm dhe me më shumë

shpërblime. Po kështu edhe kthimi i selamit. Disa vëllazër mendojnë se e kanë kryer detyrimin nëse e kthejnë selamin, por pa i dhënë rëndësi mënyrës se si e kthejnë, duke e shoqëruar atë me ironi dhe pa shpirt. Mënyra e duhur është që selami të pritë në formën më të mirë, duke e përcjellë muslimanin me buzëqeshje dhe dashamirësi, ose të paktën duke e kthyer atë me mirësi ashtu siç iu dha. Këto norma duhet të kihet parasysh edhe në dhënien e këshillës, në urdhërimin për mirë dhe në ndalimin e të keqes, në marrëdhëniet me prindërit etj. Për të gjitha këto nevojitet nga muslimani që t'i kryejë me finesë dhe butësi.

“Çelësat e hyrjes në shoqëri”

Në kuadër të programit të Lidhjes së Hoxhallarëve të Shqipërisë u organizua në Tiranë një seminar dy ditor në datat 25-26 Maj 2013, me 45 hoxhallarë nderuar nga e gjithë Shqipëria. Ky seminar pati në qëndër të vëmendjes një temë të rëndësishme “Çelësat e hyrjes në shoqëri”

Në këtë organizim të rradhës të Lidhjes së

Hoxhallarëve e nderoi me pjesëmarrjen e tij dijetari i nderuar nga Medina e Arabisë Saudite Shejh Jahja Ibrahim El-Jahja, i cili foli për temën e lartpërmendur nëpërmjet disaelementëve të rëndësishëm, siç janë aspekti social, akademik, edukativ etj.

Dijetari i nderuar, Prof. Dr. Jahja Ibrahim El-Jahja është një personaliteti nderuar në Arabinë Saudite, ai ka një kontribut të madh në çështjet humanitare dhe në edukimin e disa breza studentësh, nga e gjithë bota islame.

Dr. Jahja bin Ibrahim El-Jahja ai ka qenë për një kohë të gjatë drejtor i çështjeve studentore në Universitetin Islamik të Medines në Arabinë Saudite. Ai gjithashtu është shquar gjithashtu për rolin e tij edukues dhe dashamirësinë e madhe që ka treguar dhe tregon me njerëzit, në veçanti me studentët e huaj që vijnë nga vendet e ndryshme të botës, të cilët gjenin tek ai një baba të dashur dhe një prind të dhembshur.



Analizë / Edukimi fetar si një kusht i domosdoshëm i progresit social

Nga Enklid PELARI

PSE EDUKIMIT?

"Nëpërmjet edukimit shoqëritë përpriqen të "strukturojnë" botën shpirtërore të pjesëtarëve të tyre rreth disa vlerave, që këto shoqëri i shpallin zyrtare. Me një fjalë, edukimi është një farë "programimi", nëpërmjet të cilit shoqëritë me organe të specializuara synojnë të konvertojnë sistemin e vet normativ në një sistem vlerash, duke e "modeluar" kështu botën shpirtërore të individëve sipas kriterëve të veta. Kështu shoqëritë përpriqen të krijojnë dhe të ruajnë kohezionin shoqëror."

PO SHIFRAT (STATISTIKAT) Ç'THONË?

Shumë studime të realizuara nga Banka Botërore, OCDE-ja, Komisioni Evropian etj., kanë arritur deri aty sa të pohojnë se informacioni dhe dija po zëvendësojnë kapitalin dhe energjinë, si faktorë bazë të krijimit të pasurisë e mirëqenies, ashtu si këto dy të fundit zëvendësuan punën e dorës dhe pronën e tokës dy shekuj më parë. Për më tepër, progresi teknologjik i shekullit XX e ka transformuar pjesën dërrmuese të punës që krijon pasuri nga një bazë fizike në një bazë dije e njohurish.

Kështu p.sh. në mesin e shek. XIX, kapitali fizik përfaqësonte 65-70% të kontributit në rritjen e rendimentit të punës, ndërsa në fund të shek. XX, ai përfaqësonte vetëm 20-25% të këtij kontributi. Shek. XXI po e thallon akoma më shumë këtë tendencë duke e zbritur nën 20% kontributin e kapitalit fizik. Teknologjia dhe dija konsiderohen si faktorët çelës të prodhimit dhe rritjes. Ekonomistët kanë filluar të mendojnë se tashmë është e nevojshme të realizohet një revolucion i tërë dhe në treguesit e matjes dhe shprehjes së kësaj ekonomie të re gjithnjë e më jo-materiale.

PSE TEOLOGU?

Nisur nga statistikat, të cilat tregojnë për nevojat e zhvillimit për formim fetar, po evidentojmë disa argumente, se përse duhet integruar teologu në mësimdhënie dhe çfarë dobish do të kenë entet arsimore nga ky bashkëpunim:

1- Pikë së pari, shoqëria është në krizë morale për sa i përket moshës së pubertetit, adoleshencës dhe periudhës post-adoleshencë. Nga takimet e ndryshme që kemi patur me drejtorë të shkollave na është raportuar, se rinia ka nevojë për etikë dhe edukatë fetare. Po ti bënim një shpjegim psiko-anatomik këtij fenomenin do të shtonim se hormonet dhe gjëndrat e hipofizës tek të rinjtë maturohen përpara pjekjes së tyre intelektuale dhe pikërisht në këtë moshë ata kanë nevojë për përkujdesje prindërore dhe instruksione morale, që mos të bien pre e indulgjencave dhe e pasioneve të tyre.

2- Do të krijohej respekti dhe konsiderata e teologut në shoqëri. Sepse tanimë ata nuk shihen si njerëz hermetikë

të ardhur nga një botë tjetër, por si kontribuues moralë dhe mësues të shoqërisë.

3- Së treti, do të siguronte të ardhura për teologët nga buxheti i shtetit, çka nuk do t'i detyronte këta të fundit të bënin punë rutinë dhe rrjedhimisht shoqëria në tërësi, por edhe komuniteti ynë në veçanti nuk do të humbte më vlera dhe resurse humane të konsiderueshme. Ky harxhim energjish dhe firoje intelektuale përveç regresit do ta thellonte edhe me tej krizën morale të shoqërisë sonë.

4- Penetrimi teologut në shoqëri, konkretisht në çdo familje me anë të nxënësve, do të krijonte ura të reja komunikimi midis teologut dhe popullit. Kjo shkrimje akujsh do të shërbente që teologu të njihet më nga afër me hallet e popullit, çka do të motivonte këta të fundit që të japin kontributin e tyre me prezencë në objektet e kultit dhe në aktivitetet fetare. Kjo gjë do të rriste formimin e prindërve të të ardhmes çka do përkthehej në fryte të mira morale për anëtarët e rinj të shoqërisë.

5- Shoqëria jone i ka ezauruar tashmë të gjitha alternativat dhe modalitetet e edukimit të rinisë, duke filluar nga kurrikulat e ndryshme, si sociologjia, etika, lënda e zhvillimit të karrierës, edukata seksuale etj., të cilat shpesh herë e kanë thelluar edhe me tej këtë hendek. Ajo që mbetet për t'u provuar është "ilaçi" fetar, i cili nuk mund të hidhet poshtë nga shoqëria relevante, sepse është "i hidhur", por duhet rekomanduar nga drejtuesit, si kurë emergjente për sëmundjet sociale. Aq më tepër që studimet statistikore, por edhe dëshmitë empirike kanë dëshmuar se kjo alternativë ka bërë "mrekulli" me shtresat problematike sociale si: Konsumuesit e lëndëve narkotike, trafikantëve, njerëzve të implikuar në akte kriminale etj.

OK ARSIMIT LAIK, PSE FETARIT?


Promovimi i formimit fetar, apo siç quhet në gjuhën ekonomike kapitali human, apo kapitali social është i një rëndësie të lartë për çdo shoqëri. Promovimi i tij është bërë nga politologu amerikan Robert Putman më 1995. Putman i tronditi të gjithë me vizionin e tij të veçantë për rëndësinë e kapitalit social, kur nënvizonte, se "nëse në SHBA do të kishte një degradim të kapitalit social, kjo do të shkaktonte një dobësim të pjesëmarrjes politike dhe angazhimit të shoqërisë civile duke goditur rëndë vitalitetin e demokracisë dhe ekonomisë amerikane". I zhvilluar më tej nga autorë si Coleman, Bourdieu, por dhe nga institucionet më të rëndësishme ndërkombëtare si FMN, Banka Botërore, OCDE, BERZH, OKB etj., kapitali social konsiderohet si një faktor me impakt determinues në ritmet e zhvillimit ekonomik, efikasitetin e investimeve dhe projekteve të zhvillimit, nivelin e mirëqenies, cilësinë e shëndetit publik, stabilitetin dhe kohezionin social të një shoqërie, shteti apo territori, nivelin e korrupsionit, informalitetit e kriminalitetit. Sipas OCDE, rezultoni që nocioni i kapitalit social është shumë i

nevojshëm në ecurinë dhe rezultatet e punës qeverisëse dhe se kapitali social ndikon ndjeshëm në reduktimin e pabarazisë sociale dhe prodhon efekte shumë pozitive në nivel makroekonomik.

Ky eksternalitet pozitiv —siç quhet në gjuhën ekonomike— në plan afatgjatë sjell një progres të qëndrueshëm social, larg gangrenave të çdo pushteti —siç thotë ibën Haxher El Askalani— të cilat janë: Mitmarrja, nepotizmi, korrupsioni etj. Sepse ndjesia e vëzhgimit hyjnor dhe autokritika subkonshenciale tek i riu ruajnë ekuilibrat moralë dhe sigurojnë një performancë të mirë tek ndërtuesit e shoqërisë së ardhme. Dhe këtë gjë nuk e siguron vetëm se religjioni me anë të edukimit fetar.

Ç'TË BËJMË NE?

Nisur nga thënia e Platonit se: "Idetë modelojnë realitetet" ne si aktivistë të shoqërisë, por edhe si myslimanë duhet të ndryshojmë realitetin tonë të hidhur social, i cili rëndohet çdo ditë e më shumë, të hapim një kapitull të ri në arsimimin e brezave të ardhshëm. Turpi nga identiteti ynë fetar po na çon në identitete të turpshme, prandaj duhet medoemos implementimi i ideve në terren për të modeluar një realitet dinjitoz për të ardhmen dhe progresin tonë kombëtar dhe siç e thamë kjo gjë fillon pikërisht nga arsimimi dhe programimi brezave të rinj me kapitale humane dhe sociale. **Si gjithmonë postulati thotë një shoqëri e mire një edukim i mire.**



Lënda e mësimbesimit në arsimin universitar

Forumi Intelektual Mysliman në vazhdim të nismës së ndërmarrë më herët nga Forumi Musliman i Shqipërisë organizon një tryezë të rrumbullakët me temë: "Përfshirja e lëndës fetare me zgjedhje në kurrikulat e arsimit parauniversitar sipas modelit evropian". Në këtë takim morën pjesë të gjitha shoqatat dhe organizatat që luftojnë për këtë qëllim. Gjithashtu i ftuar për të sjellë eksperiencën e tij, ishte deputeti në Kuvendin e Republikës së Kosovës & Kryetari i Komisionit për liritë fetare në Kosovë Mr. Amir Ahmeti. Nga fusha e politikës morën pjesë deputeti i qarkut të Elbasanit Aurel Bylykbashi, zv/ministri i ministrisë së Arsimit Dritan Tana dhe kryetari i Komitetit për Kultet avokat Rasim Hasanaj. Përhëndeti këtë takim myftiu i Elbasanit Agim Duka. Takimi u moderua nga hoxhë Arben Ramkaj, i cili ia dha fjalën të parit mysafirrit nga Kosova, Amir Ahmeti, që solli përvojën evropiane në këtë fushë. Më pas e mori fjalën deputeti Bylykbashi, i cili premtoi mbështetje të plotë ndaj kësaj nisme të lavdërueshme, tha ai. Më pas fjalën e mori zv/ministri i arsimit, i cili foli rreth modaliteteve të futjes së lëndës së mësim-besimit nëpër shkolla. Në fund e mbylli këtë takim dhe theksoi rëndësinë e tij hoxhë Arben Ramkaj, i cili shprehu njëkohësisht edhe kënaqësinë e të pranishmëve për të gjitha ato që u diskutuan aty.



VAJ HABE SEUDA

SHËRBEN PËR SHËRIMIN E SHUMË LLOJ SEMUNDJEVE



ÇMIME SHUMICE & PAKICE

CEL: 069 65 10 826

067 31 19 152



DYQANI I MISHIT "HALLALL"

- ✓ Tregton mish vici, qengji, qofte dhe sallameri të firmës "Meka", me shumicë dhe pakicë.
- ✓ Ofron qengja për kurbanë dhe akika.

Adresa: Rr. "Bedri Cullhaj", tek Goni,
pranë Xhamisë së Kombinatit
Tel: 04 2350569; Cel: 0672050070
Email: agronxhepa@hotmail.com

DYQANI I MISHIT "HALLALL", Kombinat

A.M.B.C

ALBANIAN

MUSLIM

BUSINESS

CENTRE



www.lidhjatregtareve.com